



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
**ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS**  
Komora Farmaceuta Kosova  
Kosova Chamber of Pharmacists



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës  
Komora Farmaceuta Kosova  
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 22 Dt. 29.06.2019

**RREGULLORE PËR**  
**EDUKIMIN E VAZHDUESHËM PROFESIONAL**

Prishtinë, 2019

**KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS**, në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 në lidhje me nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë Nr. 04/L-150 dhe nenit 20, paragrafi 1, në lidhje me nenin 15, paragrafi 7 të Statutit të Odës së Farmacistëve të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29/06/2019, nxjerrë këtë:

## **RREGULLORE PËR EDUKIMIN E VAZHDUESHËM PROFESIONAL**

### **KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, llojet, programet dhe procedurat e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (në tekstin e mëtejshëm EVP), akreditimi i programeve të EVP-së, përkrahja financiare për profesionistët shëndetësorë dhe shoqatave profesionale që organizojnë aktivitete të EVP-së, vlerësimin e të gjitha formave të EVP-së si dhe çështje të tjera të rëndësishme që ndërlidhen me EVP.

#### **Neni 2 Fushëveprimi**

1. Kjo rregullore zbatohet ekskluzivisht për mbikëqyrjen, vlerësimin dhe përkrahjen e aktiviteteve të EVP-së për profesionistët në lëminë e farmacisë, si dhe për valorizimin e pikëve kredituese për rilicencim të profesionistit shëndetësor nga lëmia e farmacisë.
2. EVP i farmacistëve përfaqëson një proces të vazhdueshëm të përvetësimit të njohurive të reja dhe aftësive të reja praktike, në përputhje me trendet e zhvillimit të profesionit dhe shkencës farmaceutike, që është e drejtë dhe detyrim i çdo farmacisti. Qëllimi i EVP-së është të zbatojë njohuri të reja në praktikë, me qëllim të ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së punës së farmacistëve.

### **Neni 3** **Përkufizimet**

Termet dhe akronimet e përdorura në tekstin e kësaj rregulloreje kanë këto kuptime:

1. **EVP** – nënkupton Edukimin e Vazhdueshëm Profesional; EVP është proces nëpërmjet të cilit profesionistët e shëndetësisë përditësojnë dijet dhe aftësitë e tyre, me qëllim të ofrimit sa më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve të tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor;
2. **Aktivitetet e EVP-së** – nënkupton aktivitetet e organizuara nga institucionet shëndetësore, shoqatat profesionale ose subjektet e tjera të përcaktuara me këtë rregullore, që kanë karakter profesional dhe që organizohen me qëllim të ngritjes së vazhdueshme profesionale të farmacistëve;  
Disa nga format e EVP janë: Kongresi, Konferenca, Seminari, Simpoziumet, Ligjëratat dhe format e tjera të përcaktuara me këtë rregullore.
3. **Valorizimi i pikëve kredituese** – nënkupton sistemin e vlerësimit të aktiviteteve që ndiqen nga profesionistët shëndetësorë për qëllime të EVP-së;
4. **Oda** – nënkupton Odën e Farmacistëve të Kosovës- OFK;
5. **Komisioni për EVP** – nënkupton organin kompetent të Odës i cili zbaton, mbikëqyr, planifikon dhe vlerëson aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm profesional dhe valorizimin e pikëve kredituese për rilicencim të profesionistit shëndetësor nga lëmia e farmacisë.

### **Neni 4** **Përbërja dhe funksionimi i Komisionit për EVP**

1. Komisioni për EVP (në tekstin e mëtejshëm: KEVP) është organi i Odës, që përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve që janë të zgjedhur nga Kuvendi i Odës, në përputhje me dispozitat e Statutit të Odës dhe akteve normative të Odës.
2. Mandati i KEVP rregullohet me Rregulloren për organizimin e zgjedhjeve, procedurën e kandidimit, mënyrën e zgjedhjes dhe revokimin e anëtarëve të organeve të OFK-së.
3. Puna dhe procedurat e vendimmarrjes së KEVP-së janë të rregulluara me Rregulloren e Punës së Komisionit.

## Neni 5 Definicionet mbi aktivitetet e EVP-së

1. EVP përbëhet nga aktivitete shkencore dhe edukative që shërbejnë për të ruajtur, zhvilluar ose rritur njohuritë, aftësitë dhe arritjet profesionale të cilat farmacisti i shfrytëzon për t'i ofruar shërbime profesionale pacientëve, shoqërisë dhe profesionit. Aktivitetet e EVP përfshijnë:
  - 1.1 Studimet pasuniversitare dhe aftësimet profesionale të farmacistëve: studimet e doktoraturës, studimet master, specializimin,
  - 1.2 Pjesëmarrjen në kongrese, konferenca, simpoziume dhe forma të tjera të takimeve profesionale, pjesëmarrje në kurse, seminare, qëndrime studimore, publikim të artikujve në revista profesionale ose shkencore ose botime të tjera, mësim në distancë (online), mentorim, raportim i efekteve anësore të barnave etj.
2. Me qëllim të unifikimit të terminologjisë së aktiviteteve të EVP-së dhe zbatimit të kësaj rregulloreje, me dispozita të këtij neni disa nga termat kanë këtë kuptim:
  - 2.1. **Kongresi** - është takim i një numri të madh të shkencëtarëve dhe ekspertëve të organizuar sipas një programi të përcaktuar për të diskutuar tema profesionale dhe shkencore. Punimet e prezantuara në kongres publikohen në përmbledhjen e punimeve, përmbledhjen e abstrakteve apo në revistë profesionale. Karakteristikë e Kongresit është se zgjat 2 (dy) e më shumë ditë dhe përsëritet brenda periudhave të caktuara.
  - 2.2. **Konferenca** - është një takim formal ku pjesëmarrësit shkëmbejnë pikëpamjet e tyre mbi tema të caktuara dhe ku ekspertë të fushës prezantojnë ligjërata ose studime të reja. Konferenca mund të zgjasë 2 (dy) ose më shumë ditë me diskutime formale që zhvillohen sipas rendit të ditës të konferencës dhe ndahet në seanca. Një seancë përmban 4-6 prezantime që zgjasin deri në 2 orë. Pas përfundimit të seancës, organizohet debat lidhur me temat e prezantuara.
  - 2.3. **Simpoziumi** - është takim i kohëpaskohshëm shkencor - profesional i ekspertëve për të debatuar për një temë saktësisht të përcaktuar, që mund të zgjasë një ose më shumë ditë. Simpoziumi është një formë e zhvillimit profesional, ku ekspertët dhe specialistët nga një fushë specifike ofrojnë njohuri për të njëjtën temë, me rekomandime dhe përmes diskutimit.
  - 2.4. **Seminari** - është aktivitet i EVP-së në kuadër të të cilit shtjellohet në aspektin teorik një temë e caktuar ku së paku 30% e kohëzgjatjes së seminarit i kushtohet diskutimit interaktiv në mes ligjëruesit dhe pjesëmarrësve. Seminarët janë takime të një grupi të vogël pjesëmarrësish dhe që nuk zgjasin zakonisht më shumë se një ditë.
  - 2.5. **Kurs pune** - paraqet një formë të përvetësimit të njohurive, aftësive të reja përmes ligjëratave teorike – praktike në grupe të vogla, me temë të caktuara paraprakisht. Kurset janë të organizuara me një program specifik për çështje specifike, të përbërë

nga disa komponente arsimore: ligjërata, diskutime, punë praktike, lexim, hulumtime laboratorike gjatë një periudhe një ose disaditore me nga 2-5 orë (ose më shumë) me informacione dhe mbështetje adekuatë. Kursi i kategorisë së parë është ai që siguron vlerësimin e njohurive pas mbarimit të kursit. Kursi i kategorisë 2 është një kurs për të cilin nuk kërkohet vlerësim pas përfundimit të kursit.

- 2.6. **Të mësuarit në distancë/online** – janë aktivitete të EVP-së që kryhen në mënyrë të pavarur nga ana e profesionistit shëndetësor me ndihmën e teknologjisë moderne. Videokonferencat, ueb seminarët, ueb konferencat dhe format e tjera të komunikimit nëpërmjet teknologjisë informative, e lejojnë profesionistin shëndetësor të ndjekë një program trajnimi me interes për të, pa pasur nevojë për prezencë fizike. Çdo kurs në internet duhet të përmbajë një kontroll të njohurive. OFK mund të zhvillojë një kurs në internet me palën e interesuar që plotëson kërkesat teknike dhe profesionale.
  - 2.7. **Takimet profesionale** - mund të organizohen brenda institucionit shëndetësor dhe përfshijnë ligjërata për të paktën 1 orë për një temë të caktuar dhe diskutime për të njëjtën temë. Takimet profesionale duhet të lajmërohen paraprakisht në Komisionin për EVP, të paktën 20 ditë para mbajtjes së tyre.
  - 2.8. **Shkolla verore** - është një formë e formimit edukativ, i cili zhvillohet gjatë verës për disa javë për të fituar njohuri të reja praktike dhe profesionale.
3. Karakteri kombëtar apo ndërkombëtar i një aktiviteti të EVP-së përcaktohet në bazë të pjesëmarrjes së ekspertëve dhe shkencëtarëve. Një aktivitet i EVP-së në Kosovë mund të marrë karakterin ndërkombëtar nëse të paktën  $\frac{1}{4}$  e Komitetit Shkencor dhe/ose  $\frac{1}{4}$  e pjesëmarrësve aktivë (ligjërues, autorë) janë nga vendet e tjera, dhe prezantimet e tyre kryhen në gjuhën angleze.
  4. Aktivitetet e EVP-së në mënyrë që do të akreditohen duhet të mbulojnë fushat e mëposhtme:
    - kujdes farmaceutik,
    - farmakoterapia,
    - farmakologjia,
    - farmakognozia,
    - farmaci klinike,
    - dizajnimi i barnave,
    - hulumtimi dhe kontrolli i barnave,
    - farmakovigjilenca,
    - farmakodinamika dhe farmakokinetika
    - fitoterapia,
    - kimia farmaceutike,
    - biokimia,
    - toksikologjia,
    - bromatologji,

- aftësia konsultative dhe komunikim,
  - etika farmaceutike dhe deontologjia,
  - rregullativë farmaceutike,
  - farmakoepidemiologjia,
  - kozmetikë,
  - homeopatia,
  - farmakopea,
  - farmaci sociale,
  - farmakoekonomia,
  - farmakoinformatika,
  - marketing,
  - historia e farmacisë,
  - aplikimi i kujdesit shëndetësor në praktikën farmaceutike,
  - fushat e tjera që parashihen me kurrikulat e studimeve në farmaci.
5. Mënyra e akreditimit të aktiviteteve të EVP-së në mënyrë të detajuar do të jepet në Shtojcën I – Sistemi i akreditimit të aktiviteteve të EVP-së.

#### **Neni 6**

#### **Ushtrimi i funksionit të EVP-së**

1. Mbikëqyrjen dhe aranzhimin e aktiviteteve të EVP-së, e ushtron KEVP, si komision i përhershëm i OFK-së.
2. KEVP në ushtrim të këtij funksioni publik, do të ketë këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - zbatimi i procedurave të veçanta administrative për evidentimin e EVP-së;
  - krijimi i kushteve dhe stimulimi i sponsorizimit të aktiviteteve të EVP-së;
  - zbatimi i buxhetit të Odës për përkrahjen e pjesëmarrjes në aktivitete të EVP-së nga anëtarët e OFK-së;
  - zbatimi i buxhetit të Odës për përkrahjen e organizimit të aktiviteteve të EVP-së;
  - akreditimi i aktiviteteve të EVP-së;
  - akreditimi i planeve vjetore dhe programeve për EVP;
  - valorizimin e pikëve të fituara nga anëtarët e OFK-së për nevojat e rilicencimit;
  - menaxhimin e regjistrimit të aktiviteteve të EVP-së;
  - kryen edhe funksione të tjera sipas nevojave për plotësimin e qëllimit të kompetencës publike për EVP, të bazuar në legjislacionin në fuqi dhe akteve të brendshme normative të OFK-së.

## KAPITULLI II - AKREDITIMI I AKTIVITETEVE

### Neni 7

#### Subjektet e autorizuara për ofrim të aktiviteve të EVP-së

1. Në cilësinë e subjekteve të autorizuara për ofrim të EVP-së, janë:
  - 1.1. Oda e Farmacistëve të Kosovës;
  - 1.2. Shoqatat Profesionale të Farmacistëve/Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë;
  - 1.3. Institucionet shëndetësore të kujdesit shëndetësor;
  - 1.4. Institucionet e arsimit të lartë të akredituara nga organi kompetent i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
  - 1.5. Subjektet biznesore/fitimprurëse që kanë veprimtarinë e regjistruar të ndërlidhur me fushën e farmacisë/mjekësisë.

### Neni 8

#### Procedura e akreditimit të planit vjetor dhe programit të KEVP-së

1. KEVP në kuadër të përpilimit të planit dhe programit vjetor për EVP do t'i propozojë Këshillit Drejtues të OFK-së, të organizojë aktivite për qëllime të EVP-së, të paktën 2 (dy) herë në vit me ç'rast do të përmbushë minimumin e pikëve të nevojshme për rilicencim të anëtarëve të saj.
2. Subjektet nga paragrafi 7 planin për aktivitetet ia dorëzojnë KEVP-së më së largu deri më 31 dhjetor të vitit paraprak. Subjektet që nuk respektojnë afatin, humbin të drejtën për akreditimin e aktivitetit.
  - 2.1 Përmbajtja e planit për aktivitetet përcaktohet me vendim të Këshillit Drejtues.
3. KEVP mund t'i propozojë Këshillit Drejtues të OFK-së që aktivitetet e tilla t'i organizojë në bashkëpunim me ndonjërin nga subjektet e autorizuara sipas nenit 7.
4. Pjesëmarrja në aktivite që janë të organizuara nga OFK-ja mund të kufizohet në pjesëmarrjen vetëm të anëtarësisë së Odës, në raste të caktuara me arsyetim profesional.

### Neni 9

#### Dokumentet e nevojshme për akreditim të aktiviteve të EVP

1. Subjektet e autorizuara për organizim mund të parashetrojnë kërkesë për akreditim të aktivitetit të EVP-së pranë Komisionit për EVP.  
Aplikuesit për akreditim të aktivitetit të EVP-së, janë të obliguar t'i dorëzojnë dokumentet si në vijim:

- 1.1. Aplikacionin e akreditimit të plotësuar në mënyrë elektronike, të nënshkruar dhe vulosur me vulë përkatëse; Shtojca II – Aplikacioni për akreditim të aktiviteteve të EVP-së;
  - 1.2. Programin e hollësishëm të aktivitetit duke përfshirë përcaktimin e objektivave, përmbajtjes, metodologjisë, orarin dhe vendin e mbajtjes së aktivitetit;
  - 1.3. Certifikatën e regjistrimit të subjektit;
  - 1.4. Dëshminë e pagesës së taksës administrative në xhirlogarinë e OFK-së;
  - 1.5. Raportin e këshillit shkencor me listën e ligjëruesve/autorëve me CV ose shkallën akademike dhe institucionin ndërlidhës dhe temat/abstraktet e përcaktuara për ligjërime.
2. Dështimi për të plotësuar dokumentacionin e përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, paraqet bazë për refuzimin e akreditimit të aktivitetit.
  3. Vetëm aplikacionet e kompletuara do të merren në shqyrtim nga ana e KEVP. Subjekti është i obliguar që të aplikojë të paktën 45 ditë para datës së mbajtjes së aktivitetit. Asnjë aplikim jashtë këtij afati nuk do të shqyrtohet nga ana e KEVP, përveç rasteve me kërkesë të Këshillit Drejtues të OFK-së.
  4. Brenda 15 ditëve pas aplikimit KEVP shqyrton aplikacionin me dokumentacionin përkatës dhe në rast të akreditimit të planit dhe programit lëshon vendim me të cilën akreditohet aktiviteti i EVP-së.
  5. Nënshkrimi i Kryetarit të Komisionit është rekomandim për Kryetarin e OFK-së për nënshkrim.
  6. Në rast të refuzimit të akreditimit të programit, ose subjektet e pakënaqura me vendimin e KEVP mund të paraqesin ankesë pranë Këshillit Drejtues të Odës në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

## **Neni 10**

### **Kriteret financiare për akreditim të aktivitetit për EVP**

1. Me rastin e aplikimit për akreditim të aktiviteteve të EVP, subjektet duhet të paguajnë taksën administrative si në vijim:
  - 1.1. Kongreset dhe konferencat pa pjesëmarrje ndërkombëtare - pagesa prej 700.00 euro;
  - 1.2. Kongreset dhe konferencat me pjesëmarrje ndërkombëtare - 800.00 euro;
  - 1.3. Simpoziumet dhe seminarët pa pjesëmarrje ndërkombëtare — 400.00 euro;
  - 1.4. Simpoziumet dhe seminarët me pjesëmarrje ndërkombëtare — 500.00 euro;
  - 1.5. Kurse pune – 150.00 euro;

- 1.6. Takimet profesionale – 50.00 euro;
- 1.7. Të mësuarit online në sistemin e lansuar nga OFK – për individ 20.00 euro;
- 1.8. Aktivitetet e organizuara nga kompanitë prodhuese ose qarkulluesit farmaceutikë me shumicë (ortopedike, mjekësore, stomatologjike, etj.) - 900.00 euro;
- 1.9. Subjektet e akredituara paguajnë 10% të kuotizimit të caktuar nga ta për pjesëmarrje, certifikatat e të cilëve dorëzohen në OFK për nënshkrim;
  - 1.9.1. Subjektet të cilat nuk kanë kuotizim për pjesëmarrje nuk paguajnë për certifikatat e dorëzuara në OFK për nënshkrim.

## **Neni 11**

### **Kriteret e formës dhe mënyrës së lëshimit të certifikatave për aktivitetet e EVP-së**

1. Certifikata e pjesëmarrjes në aktivitetet e akredituara nga OFK-ja, lëshohet vetëm në përfundim të aktivitetit.
  - 1.1. Certifikatat duhet të jetë e shtypur në formatin standard A4;
  - 1.2. Certifikatat duhet të përmbajnë logon zyrtare të OFK-së, e cila vendoset në këndin e sipërm të djathtë të certifikatës. Në këndin e poshtëm të djathtë duhet të përmbajë vendin për nënshkrimin e Kryetarit të KEVP, në emër të KEVP-së;
  - 1.3. Certifikatat në të cilat organizator është vetëm OFK-ja, përmbajnë në qendër logon e Odës, ndërsa në këndin e majtë poshtë vendin për nënshkrim të Kryetarit të OFK-së, ndërsa në këndin e djathtë poshtë vendin për nënshkrim të Kryetarit të KEVP;
  - 1.4. Certifikata duhet të përmbajë në tekstin e saj emërtimin e plotë të aktivitetit, emërtimin e organizatorit, datën edhe vendin e mbajtjes dhe pikët kredituese, duke specifikuar pjesëmarrjen (aktiv ose pasiv).
2. Subjekti zbatues i aktivitetit të akredituar është i obliguar që certifikatat t'i dorëzojë pranë KEVP së bashku me listën e nënshkruar të pjesëmarrësve, më së largu 10 ditë pas përfundimit të aktivitetit.
  - 2.1. Një kopje e listës së pjesëmarrësve i bashkëngjitet dosjes së aplikimit dhe e njëjta nënshkruhet nga Kryetari i KEVP-së, duke specifikuar edhe numrin e certifikatave të nënshkruara për aktivitetin në fjalë.
    - 2.1.1. Pjesëmarrësit e programit të përfshirë në Listë, i regjistrohen pikët e pjesëmarrjes në sistemin elektronik.

## **Neni 12**

### **Mbikëqyrja e aktiviteteve**

1. KEVP do të mbikëqyrë zbatimin e planit të akredituar përmes mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë nga grupi i autorizuar nga Komisioni, apo edhe me kontaktet e drejtpërdrejta të Komisionit me përfaqësuesin e subjektit që zbaton planin dhe programin e akredituar.
2. Në rast se subjekti i cili zbaton planin dhe programin e akredituar nuk i përmbahet përshkrimeve për të cilat është lëshuar vendimi për akreditim, KEVP mund do të revokojë vendimin dhe aktivitetet do të konsiderohen si të paakredituara.
3. Në rast të mosrespektimit të kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore, KEVP mund të ndërmarrë masa me shqiptim të ndalimit të akreditimi për periudhë nga 3 deri në 5 vjet. Masa e tillë do të evidentohet në regjistrin e EVP të cilin e mirëmban KEVP.
4. Në ueb faqen e OFK-së do të publikohet regjistri me aktivitetet e akredituara i përditësuar. Revokimi i akreditimit do të evidentohet gjithashtu në Regjistrin e aktiviteteve të EVP-së.
5. Aktivitetet e vijuar deri në revokim të vendimit do të konsiderohen si të akredituara.

## **Neni 13**

### **Vlerësimi i aktivitetit**

1. Secili aktivitet i akredituar duhet t'i nënshtrohet vlerësimit. Procesin e vlerësimit të brendshëm e realizon vetë organizatori i aktivitetit dhe kjo shërben si bazë për vlerësimin e jashtëm të aktivitetit.  
Gjatë vlerësimit të aktivitetit, organizatori duhet të dëshmojë se janë përmbushur objektivat dhe pritshmëritë nga organizimi.
2. Në rast të ndryshimit të ligjëruesve dhe trajnerëve (ose datës së mbajtjes së aktivitetit) nga ata të deklaruar në dosjen e aplikimit, ofruesi duhet të paraqesë një sqarim me shkrim pranë KEVP të paktën 7 ditë para mbajtjes së aktivitetit, duke dëshmuar ekspertizën e personit të përzgjedhur. Ndërrimi i renditjes së temave ose sesioneve mund të lejohet, nëse nuk cenohet kohëzgjatja dhe lidhja logjike mes temave.  
KEVP do të njoftojë organizatorin nëse ndryshimet e paraqitura ndikojnë në procesin e akreditimit.
3. Ofruesi duhet të regjistrojë të gjithë pjesëmarrësit në aktivitet, duke mos lejuar regjistrimin e personave që nuk janë të pranishëm në aktivitet ose regjistrimin pas fillimit të aktivitetit. Regjistrimi mund të kryhet vetëm në periudhën të cilën paraprakisht e deklaroi organizatori dhe duhet të jetë i tillë që duhet të mundësojë përcjelljen e të gjithë aktivitetit, ose seancave të caktuara, nëse akreditimi është bërë ndaras për secilin seancë.

4. Vlerësimi i jashtëm kryhet nga ana e KEVP, përkatësisht grupi punues që përcaktohet nga ana e KEVP. Vlerësimi i aktivitetit nga ana e KEVP kryhet në dy faza dhe përfshinë fazën e akreditimit të aktivitetit pas shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit dhe fazën e monitorimit dhe vlerësimin përfundimtar. Gjatë fazës së dytë të monitorimit dhe vlerësimit përfundimtar, KEVP cakton një grup punues 2 (dy) anëtarësh (1 anëtar nga KEVP dhe një anëtar nga anëtarësia e OFK-së), të cilët mund të bëjnë monitorimin, vlerësimin e mbarëvajtjes së aktivitetit, duke përfshirë monitorimin dhe regjistrimin e: rendit të ditës të deklaruar, listën e ligjëruesve/trajnerëve, listën e pjesëmarrësve, kohëzgjatjen e ligjëratave dhe temat e deklaruara. Vota e anëtarit të KEVP do të jetë mbizotëruese në rast të votimit të barabartë.
5. KEVP do të informojë organizatorin me përbërjen e grupit punues të paktën 5 ditë para fillimit të aktivitetit në mënyrë të lejimit të pjesëmarrjes mbikëqyrëse.
6. Grupi punues brenda 15 ditëve nga përfundimi i aktivitetit do t'ia dorëzojë një raport me shkrim KEVP, duke specifikuar nëse organizatori i ka përbushur dhe i është përmbajtur programit të deklaruar, sa i përket temave, ligjëruesve dhe orarit, si dhe duke specifikuar numrin e pjesëmarrësve dhe kohën e mbylljes së listës së regjistrimit të pjesëmarrësve. Nëse anëtarët e grupit punues vërejnë regjistrime pas fillimit të aktivitetit/ligjëratave, atëherë kryesuesi i grupit punues mund të nënshkruajë listën e pjesëmarrësve tek numri rendor, ku vlerëson se janë bërë regjistrime jashtë afatit.
7. KEVP ka të drejtë të monitorojë çdo kohë, edhe në mënyrë të rastësishme dhe pa njoftim paraprak aktivitetin e EVP-së të akredituar ose në procedurë të akreditimit, për të siguruar zbatimin e standardeve dhe kritereve të parashikuara.

### **KAPITULLI III - AFTËSIMI PROFESIONAL**

#### **Neni 14**

#### **Obligimi i farmacistëve për aftësim të vazhdueshëm profesional dhe portofolio personale e EVP-së**

1. Anëtari i Odës, respektivisht farmacisti, është i obliguar që t'i nënshtrohet EVP-së në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e kujdesit farmaceutik dhe të plotësojë kushtet për rilicencim.
2. Anëtari i Odës është i obliguar që brenda 5 (pesë) viteve të grumbullojë në total 100 (njëqind) pikë për pjesëmarrje në aktivitetet e EVP-së.
3. Niveli i tolerancës nga kriteri pikës 2 është 5% e pikëve.

4. Valorizimi i pikëve kredituese është kompetencë ekskluzive e KEVP. Valorizimi i pikëve për pjesëmarrje në aktivitete të EVP-së do të bëhet sipas Shtojcës III – Tabela për Valorizimi i Pikëve Kredituese, në të cilën janë përcaktuar pikët kredituese për secilin lloj të aktivitetit.
5. Me rastin e valorizimit të pikëve, KEVP lëshon vendim në të cilin konstaton valorizimin e pikëve.
6. Pala e pakënaqur me vendimin për valorizim, ka të drejtë ankese pranë Këshillit Drejtues në afat prej 7 (shtatë) ditë nga dita e pranimit të vendimit për valorizim.

#### **Neni 15**

##### **Mënyra e llogaritjes së pikëve**

1. Anëtari i Odës është i obliguar të marrë pjesë në aktivitete të EVP-së në mënyrë që për çdo vit të fitojë së paku 5 (pesë) pikë dhe maksimum 40 (dyzet) pikë, duke e llogaritur nga data e lëshimit të licencës së fundit për punë.
2. Nëse një anëtar i Odës me pjesëmarrjen në EVP-së brenda një 1 (një) viti arrin më shumë se 40 (dyzet) pikë në bazë të listës së pikëve, ato pikë nuk do t'i njihen në vitin e ardhshëm sipas mënyrës së paraparë.

#### **Neni 16**

##### **Inicimi i procedurës për valorizim të pikëve**

1. Anëtari i Odës inicion procedurën e valorizimit të portofolios personale përmes parashtrimit të aplikacionit në Shtojcën IV – Formular për Valorizim të Pikëve Kredituese.
2. Një anëtar i Odës mund të paraqesë në KEVP një kërkesë për valorizim të pikëve kredituese më së largu 60 ditë para skadimit të afatit për lëshimin ose ripërtëritjen e licencës.
3. Nëse farmacisti për shkaqe të justifikuara (pushim mjekësor për më shumë se gjashtë muaj, shtatzënia dhe komplikimet lidhur me mbajtjen e shtatzënisë, etj.), nuk i ka plotësuar kërkesat nga neni 15, paragrafi 1 dhe 2 i kësaj Rregulloreje, KEVP mund ta lirojë aplikuesin nga obligimi për pikët kredituese për periudhën e cekur, por jo më shumë se 1 (një) vit.
4. Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, farmacisti aplikon në KEVP për përjashtim nga marrja e pikëve të nevojshme. Nëse arsyet e justifikuara nga paragrafi 1 i këtij neni zgjasin më shumë se një vjet, KEVP e dërgon kërkesën në Këshill Drejtues të OFK-së për

vendimmarrje. Kërkesat duhet të dokumentohen me arsyet e parandalimit të përcjelljes së EVP-së.

## **KAPITULLI IV – PËRKRAHJA PËR ORGANIZIM DHE PJESËMARRJE NË EVP**

### **Neni 17**

#### **Përkrahja e anëtarëve të OFK-së për pjesëmarrje në aktivitetet e EVP-së**

1. Farmacistët në cilësi të personave fizikë kanë të drejtë që të aplikojnë për përkrahje në pjesëmarrje në aktivitete të EVP-së me plotësimin e kushteve të mëposhtme:
  - 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
  - 1.2. Të kenë përgatitje adekuate profesionale; dhe
  - 1.3. Të jenë anëtarë të Odës.
2. Kriteret për përkrahje të anëtarëve të OFK-së pjesëmarrjes në aktivitete të EVP-së përfshijnë: (përfshirja e aktivitetit në indeksim) - sipas udhëzimit administrativ të MASHT
  - 2.1. Plotësimi i Aplikacionit për pjesëmarrje në aktivitetet e EVP-së në Shtojcën V në formë elektronike, i nënshkruar dhe i dorëzuar të paktën 15 ditë para mbajtjes së aktivitetit; ndërsa për publikime deri në 15 ditë pas marrjes së konfirmimit;
  - 2.2. Aktiviteti për të cilin kërkohet përkrahja duhet të tregojë qartë relevancën e tematikës lidhur me të arritura në fushën e farmacisë;
  - 2.3. Kredibiliteti i aktivitetit, organizatorit dhe tematikës së aktivitetit për të cilin kërkohet përkrahja në pjesëmarrje;
  - 2.4. Roli i aplikuesit në aktivitet (duhet dëshmuar me dokument relevant) duhet të jetë:
    - Ligjërues apo autor i ftuar (vetëm autori i parë);
    - Pjesëmarrës me poster prezantim (vetëm autori i parë);
  - 2.5. Mundësia për të transmetuar përvojat dhe njohuritë e fituara nga pjesëmarrja në aktivitet. Aplikuesi duhet të ketë njohuri të gjuhës në të cilën mbahet aktiviteti;
  - 2.6. Aplikuesi duhet të pajiset me certifikatën për pjesëmarrje/ose me një dokument që dëshmon pjesëmarrjen në cilësinë e ftuar.
3. Mbështetja financiare për prezantimet me gojë (vetëm autori i prezantimit) janë si në vijim:
  - 3.1. Aktivitetet në të cilat OFK-ja është organizatore, autori i prezantimit do të lirohet nga kuotizimet;
  - 3.2. Shtetet e regjionit të Ballkanit dhe Turqi, kuotizimet e pjesëmarrjes, deri në maksimum në shumën prej 300.00 euro;
  - 3.3. Shtetet e BE-së, deri në shumën prej 800.00 euro;

- 3.4. Shtetet jashtë BE-së (SHBA, Kanada, Australi dhe vende të tjera në të cilat organizimet konsiderohen me relevancë), deri në shumën prej 1,200.00 euro;
  - 3.5. Poster prezantimet përkrahen në shumën deri në 50 % nga paragrafi 3.2; 3.3 dhe 3.4 i këtij neni.
4. Mbështetja financiare që përfshinë pagesën e taksës së botimit të punimeve shkencore në revistat shkencore me impakt faktor ose të indeksuara në Scopus, WOS (Web of Science), Pubmed, Current Contents. Mbështetja vlen vetëm për autorin e parë të punimit. Përfitues nga kjo kategori mund të marrë mbështetje financiare një herë në 5 vite.
  5. Anëtarët e OFK-së kanë të drejtë vetëm një herë brenda vitit kalendarik të përfitojnë mbështetje financiare.
  6. Të gjitha vendimet financiare nga neni 19 i kësaj Rregulloreje, caktohen në varshmëri prej buxhetit të aprovuar për EVP nga Kuvendi.

### **Neni 18**

#### **Përgjegjësia e përfituesit dhe mbikëqyrja e aktivitetit nga Komisioni për EVP**

1. Anëtari i OFK-së i cili ka përfituar nga përkrahja për pjesëmarrje në aktivitet, është i obliguar që në afat prej 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i eventit të sjellë raportin mbi pjesëmarrjen në aktivitet, duke i bashkëngjitur dokumentacionin i cili dëshmon pjesëmarrjen në aktivitet dhe shpenzimet e mbuluara.
2. Nëse përfituesi nuk përmbushë detyrimin nga paragrafi 1 i këtij neni, të njëjtit do t'i caktohet ndalesa për të drejtën e aplikimit për përkrahje në aktivitete në EVP për një kohëzgjatje për 5 (pesë) vite të ardhshme, lënda procedohet në Këshill Etik dhe OFK do të iniciojë procedura për rimbursim të mjeteve të alokuara.
3. Vlerësimet dhe ndalesa eventuale e shqiptuar ndaj farmacistit të cilit i është përkrahur pjesëmarrja në aktivitete të EVP-së, do të evidentohet në regjistrin për aktivitetet e EVP-së.
4. Me kërkesë të KEVP apo me kërkesën e autorit, të njëjtin punim, publikim, mund ta prezantojë në aktivitetet e OFK-së.

## KAPITULLI V - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Neni 19

Pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje janë Shtojcat I - V.

Çështjet nga fushëveprimtaria e KEVP-së, të cilat nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore, do procedohen në Këshillin Drejtues të OFK-së, deri në plotësim – ndryshimin e saj.

### Neni 20

#### Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i OFK-së.

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohen të gjitha aktet e mëparshme që janë nga fushëveprimi i kësaj rregullore.

Prishtinë 29.06.2019

Kryesuesi i Kuvendit të OFK-së  
Dr.sc. Arianit Jakupi

